



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	28.04.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Zero Pozitive” SH.P.K
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtarë për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga “Zero Pozitive” SH.P.K” me të cilën kërkohet që me datë 30 Prill, 1 dhe 2 Maj 2021 nga ora 08:00 deri në 20:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, parku në Ulpianë ku do të bëhen xhirimet e kampanjës televizive “Gjithkund shkova, Princin e takova”.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike parku në Ulpianë me datë 30 Prill, 1 dhe 2 Maj 2021 nga ora 08:00 deri në 20:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.